

***SUBJEKTI “PREND PRENDI”***

***NIPT K68104502J***

***Adresa: Rruga Lezhe-Tirane km 5.***

***Komuna Zejmen-Lezhe***

**DREJTUAR: AKM-TIRANË**

**PËR DIJENI: DRM-LEZHË**

**KOMUNA -ZEJMEN**

***LËNDA: KËRKESË PËR PJESËMARRJE NË ORGANIZIMIN E KONSULTIMIT ME PUBLIKUN DHE PALET E INTERESUARA PËR APLIKIMIN PËR LEJE MJEDISI TË TIPIT B: ID 3.1/e. “PËRZIERJA DHE PËRDORIMI I ÇIMENTOS PËR: “PRODHIM SHTYLLA BETONI VRESHTI, VAZO BETONI, BLOQË BETONI” DHE TREGËTIM I TYRE.***

**SUBJEKTI : “Prend Prendi” SH.P.K. me NIPT K68104502J**

**ADMINISTRATORI: PREND PRENDI**

**ADRESA : AUTOSTRADA LEZHË -TIRANË KM-6**

**FSHATI TRESH, KOMUNA ZEJMEN, QARKU LEZHË**



Pozicioni i objektit ku do zhvillohet veprimtaria

## Permbajtja

Hyrje.....	3
1. Veprimtaria dhe teknologjia që do zbatohet.....	4
2. Procesi teknologjik ;.....	4
3. Përshkrimi i mjedisit fizik të zonës.....	6
3.1 Klima .....	6
3.2 Gjeomorfologjia .....	6
3.3 Rezervat ujore .....	7
3.4 Tokat.....	7
3.5 Sipërfaqet boshe.....	7
4. Biodiversiteti.....	7
4.1 Flora.....	7
4.2 Fauna .....	7
4.3 Ndikimet në mjedis .....	8
5. Lehtësi të tjera.....	9
6. Perfundime;.....	9

## Hyrje

---

Subjekti “**Prend Prendi**” Sh.p.k. me përfaqësues ligjor *PREND PRENDI* merret me aktivitetin “ID 3.1, e.” Përzierja dhe përdorimi i çimentos për: “Prodhim shtylla betoni vreshti, vazo betoni, blloqe betoni dhe tregëtim i tyre.

Subjekti “Prend Prendi” sh.p.k. me përfaqësues ligjor *PREND PRENDI* në përputhje me VKM nr. 419 datë 25. 06. 2014 “Për miratimin e kërkesave të posaçme për shqyrtimin e kërkesave për leje mjedisi të tipave A, B dhe C, për transferimin e lejeve nga një subjekt te tjetri, të kushteve për lejet respective të mjedisit, si dhe rregullave të hollësishme për shqyrtimin e tyre nga autoritetet kompetente deri në lëshimin e këtyre lejeve nga QKL-ja , ky subjekt duhet te aplikojë per leje mjedisi të tipit B.

Subjekti do të ushtrojë veprimtarinë ne kete mjedis per prodhimin e betonit ne sasi jo të madhe në një turn, për **Prodhim shtylla betoni vreshti, vazo betoni, blloqe betoni dhe tregëtim i tyre (Prodhimin dhe tregëtimin e disa produkteve të betonit me shumicë dhe pakicë).**

Në afersi të zonës ku zhvillon aktivitetin subjekti; nuk ka mjedise të vecanta private apo publike si: shkolla ,vepra arti, argjinatura, linje eletrike, tubacione uji që mund të dëmtohen nga zhvillimi I veprimtarisë

Hapsira para ndërtesës së Impiant për prodhimin e Betonit është e sistemuar, e rrethuar, zbukuruar me punime decorative prodhim I vete subjektit, cka dhe ka ndikuar në përmiresimin e pamjes vizuale. Nevoitet me shume hapsire per gjelberim dhe lulishte.

Përveç veprimtarise ekonomike , investitori ka berë rregullime ,sistemime të shëshit para objektit, rrugëve, ka mirembajtur sistemin e kullim kanalizimeve si ate ekzistues dhe ato te hapura nga vete subjekti.

Subjekti për prodhimin e betonit është një ndërtesë me hapësirën e nevojshme për ushtrimin e këtij aktiviteti. Duhet theksuar që subjekti ka disa vite që e ushtron këtë aktivitet në këto ambiente dhe nuk ka patur asnjehere probleme me komunitetin dhe sipërmarresit që kanë aktivitetet pranë këtij Impianti për prodhimin e betonit.

Teritori i zgjedhur është mjaft i përshtatshem për funksionimin e këtij aktiviteti duke paraqitur disa përparësi si:

- Sistem perspektiv te furnizimit me energji elektrike.
- Mundësi për zbatimin korekt të teknologjise në prodhim e transport
- Është afër rrugës nacionale Lezhë-Tiranë

Pozicioni i Impiantit për prodhimin e betonit ka të zgjidhura disa nga problemet që lidhen me anën funksionale si.

- Largësi të mjaftushme nga mjediset e banuara.
- Lehtësisht e arritshme nga fuqia punëtore.
- Zonë Industriale

**Sipërfaqja totale ku do zhvillohet veprimtaria është 2125 m<sup>2</sup> e pajisur me leje ndërtimi nga Komuna Zejmen. Kapaciteti mesatar i prodhimit dhe derdhjes se kallepeve, eshte 2 m<sup>3</sup> beton ne ditë.**

SUBJEKTI “Prend Prendi” përveçse teknologjise së përshtateshme e koherente ka krijuar dhe mjediset plotësuese për puntoret, mjetet e punës dhe automjetet. Pra ka marrë masa të plota të shëndetit dhe sigurisë në punë.

## 1. Veprimtaria dhe teknologjia që do zbatohet

Prodhimi i betonit ne sasi te vogla në turn, është teknologji e prodhimit te thjeshte dhe gjysem automatik. Lëvizja e betonit për në sheshin e derdhjes në kallëpe e përpunimi I mëtejshëm do bëhet e mekanizuar disi e mbyllur nuk do të shkaktojë asnjë ndotje mjedisore. Betonierja eshte e kapaciteteve te vogla dhe me motor benzine.

## 2. Procesi teknologjik ;

Si lëndë të para do përdoren; cimentoja, inertet (rëra e zhavorre) në fraksione të ndryshme, hekur I diametrave të vogla. Sipas produktit që do përgatitet (derdhet) sipas normave të standartizuara në impiant hidhen përbërësit e betonit; materialet e mësipërme.

Lëndët e para (Cimento, inertet) shufrat e hekurit dhe material të tjera do blihen në treg nga subjekte licensuara për këto veprimtari . Cimento blihet e ambalazhuar ne thasë, nga fabrika e cimentos “Titanik” nuk do ketë cimento të hapur. Inertet do të jenë refuxho në sheshin e depozitimit përgjithesisht të lagështa.

Betoni I pergatitur do transportohet me mjete dore për në sheshin ku janë të vendosur kallëpet për produktin që do prodhohet. Do derdhet në kallepe pasi janë vendosur ose jo shufrat dhe skeleti prej hekuri, do bëhet vibrimi I betonit me mjete të thjeshta, pas mpiksjes fillestare 3-4 orë, produktet e derdhura, mbulohen përgjithësisht me letër ambalashi apo tallash druri. Pasi lihen për të fituar fortësinë e nevojshme në ngrirje duke u spërkaste dhe me ujë, produktet hiqen nga sheshi I derdhjes dhe depozitohen në vendin e caktuar.

**Sasia e energjisë që ne harxhojmë cdo muaj varion nga 200-300 kw cdo muaj.**

Mjediset e punës dhe ato sanitare pastrohen jo me pak se një herë në ditë dhe ne raste të vecanta më shumë, dhe mbas cdo pastrimi bëhet dizifektimi I nevojshme i tyre

Veprimtaria e prodhimit të betonit, derdhja në kallepe, depozitimi dhe shitja e produkteve nuk shkakton problem shqetësuese për komunitetin, përdoruesit e rrugës dhe ndotje për mjedisin.

Me këtë raport vleresimi, sigurojmë organet përkatëse shtetërore, vendim arrëse, se zbatimi dhe teknologjia e projektuar është bashkëkohore, cilësore dhe plotëson standartet e vendosura nga Bashkimi Evropian.

Aktiviteti ynë ka bërë të mundur punësim të disa personave dhe ndikon sado pak në përmirësim të nivelit ekonomik. Në linjë për prodhime betoni janë punësuar 3 punonjës të përhershëm.

Në territorin përreth objektit infrastruktura inxhinjerie është në gjendje të mirë,

Arsyet për përzgjedhjen e këtij vendi për të kryer veprimtarin nga z. **PREND PRENDI** janë:

- Veprimtaria për prodhime të betonit zhvillohet në një vend të pershtatshëm në afërsi me rrugën auto Lezhë-Tiranë rreth 6 km larg nga qyteti I Lezhës. Ai është afër pikave të furnizimit me inerte nga lumi I Matit . Po kështu dhe subjektet që tregtojnë cimento dhe hekur janë përsëri afër në këtë rrugë auto .

- Produkti kryesor që do prodhohen, shtyllat për vreshta tashme po kërkohen gjerësisht nga banorët e zonave përreth bregut Matit e Zejmenit, Fushë-Milotit e Gurzit dhe deri në zonat e Mirditës, vreshtaria është konsideruar si prioritet në këto zona. Bandierat e vreshtit do zëvendësojnë dhe kursejnë ndjeshëm lëndën drusore të përdorura vite më parë për vreshta. Tashmë nga përdorimi i shtyllave prej betoni (bandiera) do të mundësohet një mbrojtje më e mirë e disa pyllëzimeve me halorë mesdhetar që qarkojnë këto zona. Kanë qënë pikërisht përdorimi I shtyllave prej druri në vreshta që ka cuar në dëmtime të ndjeshme të pyjeve të fshtarave të komunës.

-Vazot e madhësive të ndryshme, janë prodhime që mundësojnë kultivim të bimëve kryesisht zbukuroese e për gjelbërim mjedisesh private e publike, por mund te përdoren dhe për bimë dhe shkurre mjeksore që kultivohen në mjedise të kufizuara, etj.

-Prodhimi I blloqeve të betonit do të shërbejë në plotësimin e kërkesave të banorëve vendor në ndërtim sidomos të muravë rrethuese apo mjedisve ndihmëse të banimit.

Produktet që do prodhohen në këtë impiant kerkohen dhe I shërbejnë drejtpërsëdrejti komunitetit vendor pa I shtuar asnjë problem mjedisor zones në afërsi apo dhe larg impiantit.

### **3. Përshkrimi i mjedisit fizik të zonës**

---

#### **3.1 Klima**

---

Në zonën ku do të do të zhvillohet veprimtaria për prodhime e betonit, klima është tipike mesdhetare, me dimër të butë dhe verë të nxehtë.

Në këtë zonë mbizoterojnë erërat e veriut dhe me drejtim nga veri – perëndimi për në jug – lindja, me shpejtësi mesatare deri 5 m/sek. Ererat detare që depertojnë në fushen e Tales dhe nepermjet grykes së lumit të Matit, sjellin një lageshti të madhe atmosferike dhe presion të ulet, cka nuk mundeson levizjen e pluhurave apo krijimin e korenteve të ndryshme atmosferike. Diellëzimi: Zona ka mbi 2700 orë diell/ vit, Janari ka rreth 130 orë / vit dhe Korriku rreth 370 orë / vit. Zona është e përshtatshme për këtë veprimtari pasi temperaturat e ulëta dhe ditët me ngrica janë të pakta. Pra, përgatitja dhe derdhja e betonit thuhetse realizohet normalisht gjatë gjithë vitit pasi temperaturat e ulta nuk behen pengesë.

Rreshjet në forme shiu janë prezente në zonë sidomos në periudhen vjeshtë e vonë dhe dimër. Shpesh ato janë me intensitet të madh, por përveçse ndikojnë në ndërprerje të punës gjatë rënjes nuk kanë ndonjë ndikim në mjedis apo të shkaktojnë ndonjë përmytje ku të mund të lëvizin lëndët e para (inertet) apo produktet për të ndikur në ndotje apo demtim në mjedis. Sasia mesatare e rreshjeve është 1600-1800 mm/vit.

Në përfundim themi; se elementet klimatik të zonës ku zhvillohet veprimtaria janë të përshtatshëm, ata nuk përkeqesohen as nuk ndikohen fare nga veprimtaria jone e prodhimeve si më sipër. Mjedişi ekologjik I zones nuk ndikohet fare nga zhvillimi I veprimtarise të përshkruar me sipër.

#### **3.2 Gjeomorfologjia**

---

Objekti dhe veprimtaria zhvillohen në zonë fushore, të Ultesirës bregdetare të Lezhës. Është sipërfaqe e rrafshet e vendosur në toka aluvionale të mesme me mundesi të mira kullimi dhe të përshkueshme nga ujerat nëntoksore. Veprimtaria do zhvillohet në një sipërfaqe e cila prapakisht do të jetë niveluar dhe shtruar me beton, cka bën që të mos kemi asnjë ndotje të tokës në sipërfaqe apo thellësi nga ujerat e pakta që do përdoren.

### 3.3 Rezervat ujore

---

Uji do sigurohet nga pus artezian ekzistues. I hapur me sonda vite me parë, pra do përdoret ujë nëntoksor I cili në sasi të konsiderueshme në thellësi të vogla gjëndet në gjithë Ultësirën e Lezhës në hapsirën nga Shengjini ne lumin e Matit. Pra themi se veprimtaria jonë nuk do ketë ndonjë ndikim në ujin qe përdoret nga banoret vendor .

### 3.4 Tokat

---

Tokat në këtë zonë janë mbi formacione aluvionale, janë të hinjta dhe torfike të cilat kanë origjinë ligatinore. Tokat që qarkojne objektin ku zhvillohet veprimtaria përdoren për të mbjellë kultura të ndryshme bujqësore, pemët drufrutore, vreshta etj, të cilat janë të përhapura ne këtë zonë.

### 3.5 Sipërfaqet boshe

---

Nuk ka sipërfaqe boshe në zonë por përgjithsisht përvecse përdorimit të tokës për kultura bujqësore, si zona banimi, sipërfaqe të konsiderueshme janë zënë nga zhvillimi I bizneseve te ndryshme në dy anët e rrugës auto Lezhë-Tiranë.

**Pra themi se zhvillimi I veprimtarisë tonë nuk ndikon pra as nuk përkeqëson asnjë cilësi të faktorit edafik dhe ujerave nëntokesorë dhe atyre sipërfaqësorë**

## 4. Biodiversiteti

---

### 4.1 Flora

---

Tipi I flores në zonën ku zhvillohet veprimtaria eshte tipike mesdhetare kryesisht nga bimë gjethembajtëse por dhe gjetherënëse. Flora në distancë të aferta me objektin është bimësi barishtore e kultivuar dhe pemë të ndryshme frutore të kultivuara. Veprimtaria e prodhimit të shtyllave të betonit për vreshta (bandiera vreshti) vazove për bimë, blloqeve të betonit për ndërtim, nuk ndikon aspak në bimesinë e kultivuar afër pikës prodhimit as në bimesine natyrore larg objektit

### 4.2 Fauna

---

Duke qënë në një zonë urbane, afër rrugës auto dhe jo shumë larg mjediseve të banuara, nuk mund të themi se ka ndonjë faunë që të konsiderohet në këtë raport vleresimi. Fauna që merret në konsideratë që qarkon mjedisin ku zhvillojmë veprimtarine është kryesisht e butë. Pra fauna që ka

vlerë janë kafshe dhe shpendë shtëpiake që mbareshtohen tradicionalisht në fshat. Nga veprimtaria prodhuese në mjedisin tone, kafshët shtëpiake apo ato që rriten dhe zhvillohen në natyrë, afër apo larg pikës prodhimit, nuk ndikohen për se drejti as terthorazi në jetën e tyre aq më pak në zhdukje apo përkeqësim të gjëndjes.

**Pra në tërësi të gjithë elementet e biodiversitetit në një distancë të afërt apo të largët nuk ndikohen direkt apo indirekt nga veprimtaria prodhuese e subjektit si më sipër.**

### 4.3 Ndikimet në mjedis

---

U përshkruan dhe më lart dhe konkludohet se kjo veprimtari nuk ka asnjë ndikim keqësues në mjedis në zoant afër apo dhe larg tij. Edhe një herë mund të themi se ky aktivitet nuk pritet të ketë ndikim mjedisor të matshëm pasi:

- Nuk ka prodhim të mbetjeve të rrezikshme
- Ushtrimi i këtij aktiviteti nuk do të ndikojë në ndryshimin e nivelit të ujrave tokësore, në rrugët ujore dhe në nivelin hidrostatik të ujrave nëntokësore,
- Nuk shkakton ndotje të tokës me shkarkime të ndryshme të lëngëta apo të ngurta, ujerat që perdoren janë në sasi të pakta pra nuk ka një ujë tepër teknologjike
- Gjatë zhvillimit të këtij aktiviteti nuk do të ketë shkarkime të lëndëve ndotëse në ujë.
- Ushtrimi i këtij aktiviteti nuk do të ndikojë në cilësinë e ajrit të zonës, pasi nuk do të ketë shkarkime në ajër të gazrave, pluhurave apo tymrave.
- Gjatë ushtrimit të këtij aktiviteti nuk do të ketë emetime të ndryshme kimike të llojeve të ndryshme.
- Nuk do të ketë dëmtime të florës dhe faunës së zonës afër dhe larg vendit ku do punohet.
- Zhurmat në mjediset e punës janë brenda normës së lejuar, dhe për pasojë as zhurmat në mjediset e jashtme nuk pritet të kenë ndikim në popullatën përreth. Niveli i zhurmës nuk i kalon 55-65 dB(A) gjatë punës në këtë pikë prodhimi. Ky nivel zhurmash është brenda normave dhe nuk ndikon në shëndetin e punonjësve apo kalimtareve të ndryshëm.
- Ushtrimi i këtij aktiviteti nuk do të ketë çlirime të gazrave të ndryshme në mjediset përreth objektit e apo në brendësi të tij.
- Ka vlera normale të temperaturës dhe të lagështisë në mjediset e punës
- Janë marrë të gjitha masat për mbrojtjen në punë nga aksidentet dhe për mbrojtjen nga zjarri.
- Dukuri të tjera. Vibracioni, nxehtësia, radiacioni, ndriçimi verbues, etj, nuk janë të pranishme.



- Trafiku rrugor. Gjatë zhvillimit të aktivitetit prodhues dhe transportues nuk do ketë asnjë pengesë në levizjen normale në rrugën auto. Për në objekti ka një degëzim rrugë dhe mjetet do dalin e do hyjnë pasi me parë të kontrollojnë lëvizjet pa penguar trafikun

- Projektet e tjera si: rrugët e reja, kanalet e ujrave të zeza, banesat, linja të energjisë, naftë dhe gazsjellës, linja të telekomunikacionit etj. nuk do të ndikohen nga aktiviteti i subjektit

Mjediset e Subjektit “Prend Prendi” pastrohen rregullisht; brenda, jashtë dhe në mjediset që e qarkojnë, duke grumbudhur çdo mbeturinë urbane apo të ngurtë, duke i transportuar ato në pikën e grumbullimit e të përpunimit të mbetjeve të bashkisë Lezhë në zonën e miratuar të Berzanës, që nuk ndodhet më shumë se 12 km nga pika e prodhimit.

Punonjësit e kësaj pike për prodhimin e tre produkteve si me sipër përveçse nivelit teknik dhe profesional të vertetuar nga prodhimet cilësore brenda standardeve, janë të instruktuar për zbatimin e rregullave të sigurimit teknik në punë në përgjithësi dhe ato të punës në këto objekte në vecanti.

Punëtorët janë të pajisur me librezat shëndetësore individuale. Mbrojtja në punë dhe ruajtja e shëndetit të punonjësve që punojnë në këto pike formalizohet dhe me dokumentacionin përkatës; - Rregulloren e sigurimit teknik; - Normativat e ndotësve në mjediset e punës të miratuara nga Inspektoriati I Higjienës së Punës. Kushtet, standartet dhe garancia teknike që duhet përmbushin produktet e prodhuara nga subjekti ynë.

## 5. Lehtësi të tjera

Subjekti “..... siguron për punonjësit e saj; ujë dhe ndricim për 24 orë, vegla, mjete dhe veshje pune sipas nevojave. Shërbimi dhe mirëmbajtja e veglave dhe paisjeve teknologjike bëhet në kohë të përcaktuara dhe në orë të caktuara për të cilat puntorët paguhen.

Ndriçimi bëhet me ndriçues neon, për të qenë sa më pranë dritës natyrore dhe për të kursyer energjinë elektrike.

Subjekti “Prend Prendi” ka mjetet e nevojshme teknike dhe financiare për të zhvilluar këtë aktivitet dhe kërkon të jetë e pajisur me të gjitha lejet përkatëse sipas legjisllacionit shqiptar.

## 6. Përfundime;

Në përshkrimin e mësipërm del qartë se veprimtaria e prodhimit të bandierave për vresht, vazove dhe blloqeve për ndërtim prej betoni, në afërsi të rrugës auto Lezhë-Tiranë, 6 km pasi të pasqytetin e Lezhës në komunën Zejmen nuk ka asnjë ndikim në mjedis. Veprimtaria konsiderohet e përshatshme dhe i lejueshme në zonën e zgjedhur nga investitori, pa krijuar probleme mjedisore për zonën afër apo dhe përreth tij.

Subjekti “Prend Prendi” do ta ushtrojë veprimtarinë në përputhje me legjislacionin shqiptar në fushën e mbrojtjes së mjedisit. Në vartësi të fitimeve që do realizohen në vite nga ky biznes, subjekti parashikon dhe të investojë për përmirësimin e mjedisit, duke bashkëpunuar dhe mbështetur simbolikisht subjektet që grumbullojnë dhe përpunojnë inerte në shtratin e lumenjve nga të cilët në marrim inertet. Pra kontributi do të jepet sipas projekteve që ato subjekte kanë në rehabilitimin dhe pyllëzimin e shtretërve të lumenjve.

Duke qënë të hapur dhe të vëmëndshëm, ne do të mirëpresim çdo sygjërim që I shërben cilësisë së punës, shërbimeve dhe mbrojtjes mjedisit në tërësi.

**Motoja jonë është “Punë të mirë, produkte cilësore, në një mjedis të shëndetshëm”**

**Administratori**

**Prend Prendi**